

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

BLERINA ROGOVA GAXHA

FREDERIK RRESHPJA - KTHIMI KAH INTIMJA

Mbyllja e “kohës ideologjike” pas të ’90-ave në Shqipëri, lejoi të dalë në sipërfaqen e letrave shqipe edhe letërsia e intimes, me autorë që inicuan kode të *pastra poetike*¹, duke e veshur diskursin poetik me natyrshmërinë e tij figurative.

Në një gjysmëshekull jetë ideologjike poezia e vuajti në kurrizin e vet brengën e madhe të mundësisë e të pamundësisë së reprezentimit të ndjenjës njerëzore. Në këtë hisë, zërat e poezisë intime, qenë zëra të vetmuar.

Një nga autorët që përket me të shumtën e jetës biografike nën diktaturë, po me botimin e poezive kryesisht pas viteve ’90, është Frederik Rreshpja. Liriku unik i poezisë shqipe me poezinë e tij ka dhënë shenja të forta të kthimit të letrave kah intimja. Poeti i cili në skenën e poezisë në Shqipëri doli herët, porse dëshminë e fortë artistike e japi veçanërisht në botimet që nxorën krye tek pas viteve ’90, është autori i temave personale, që i rri larg ideologjisë dhe përherë kërkon e gjen veten. Rreshpja shkroi temat e veta, të dhembjes e të humbjes, në gjininë e tyre statutare, në lirikë. Poezia e tij shënon shkrimin e ndryshëm nga tradita, tekstin e brendisë emocionale, të metafizikës e të kozmologjisë individuale. Ai nuk bëri kompromise e nuk i pranoi skemat e ngushta doktrinare, duke flakur tutje poetikat e letërsisë socrealiste dhe më vonë edhe të asaj që lindi si letërsi e pasojës.

Por cila është bota për të cilën jeton, dëshiron e ëndërron poezia e Rreshpjes? Teksti i tij mbi të gjitha është lexim i jetës nëpërmjet jetës personale. Rreshpja shkroi dhembjet e jetës, përmbetje në vete për ta njohur botën dhe këtë njohje e artikulonte si përmbetje personale. Heroi i poezisë së tij është humbësi, prandaj në këtë poezi projektohen dëshirat e përmbysura, që të motivuara nga shpirti njerëzor japin vajin e tij metafizik, shpesh në përmasa dramatike.

Kësisoj, ky tekst në komunikim me poezinë e Frederik Rreshpjes, synon të shfaqë pamje të identitetit poetik të tij me fokus kryesor shenjat e forta të kthimit të poezisë shqipe kah intimja.

Rrëfim mbi dramën personale

Frederik Rreshpja është artisti që projektoi veten në poezi. Trashëgimia letrare e tij është e projektuar në vetminë poetike, ngjashëm asaj që pati në jetë, ecjen nëpër të cilën e la shenjë e testament letrar. Duke pasur përballë modelin e ashpër të jetës, poezinë e shkroi si rrëfim mbi dramën personale.

Rreshpja nuk iu bashkua poezisë socrealiste e nuk i këndoi ideologjisë komuniste ashtu siç e kërkonte shteti komunist shqiptar. Diferencimi që i bëri qenies poetike nga qenia sociale e politike, e diferencoi atë nga skena e letrave

¹ K. Rrahmani, *Letra e Ideologji, një hyrje shkurte në letrat bashkëkohore shqipe*, Aikd 99, Prishtinë, 2012, f 203-208

shqipe të shkruara nën diktaturë. Refuzimi ndaj një poetike të vrazhdë ishte përgjigje e poetit që destinim pati prejken e përjetimeve esenciale të shpirtit njerëzor. Mbyllja në vetminë fizike e shpirtërore që qelia, nga ku krijoi dëshminë e vetes së tij.

Emri i Rreshpjes shënon poezinë e tekstit të lidhur me veten Unë; të atij që shkruan me mallin e njeriut të vetmuar, vetes që hap botën e vdekjes në poezi dhe shkruan vargjet e zeza. Ai shkroi e dashuroi poezinë e njeriut përbrenda, duke nxjerr nervin poetik si testament të tij. Poetin e intimes, të vetmisë fizike e metafizike, të dhembjes, të ëndërrimit, të vdekjes, poetin që zgjodhi diskursin personal e aventurat personale, karshi diskursit objektiv dhe pompozitetit e lavdit nacional.

Në kodin biografik, Rreshpja do të pohonte në intervistën e fundit që dha pak para vdekjes, se poezia për të ishte vetëm një shlyerje e borxhit ndaj vetes. *Qëllimi i poezisë është vetëm atëherë kur e shkruan*² ...dhe me këtë poeti sikur paqëton universin e vet.

Rreshpja do jetë së pari e së fundi një lirik i madh. Personazhi i veçantë i poezisë: *Ai është liriku i thellë i letrave shqipe që me poezinë kishte pakt e miqësi origjinare, një lidhje organike krejt të veçantë në letrat shqipe*. Kështu shkruan studiuesi Kujtim Rrahmani, i cili evidenton se ashtu siç Lasgush Poradeci e kishte rikthyer letërsinë shqipe në trungun e letërsisë, si natyrë e funksion i tekstit letrar, gjatë gjysmës së parë të shekullit 20, Rreshpja ia ktheu këtë dinjitet poezisë shqipe në fund të shekullit.³

Tekstet e shenjës personale - Vetmia është shenjë e madhe e identitetit të kësaj poezie. Dramatikë e brendshme që del në tekstin e nëntekstin e saj. Lëmsh i vetmisë së qenies ku poeti këndon i kthyer kah vetja, duke i dhënë zë vetes së emocioneve dhe esencës personale. E tërë poezia e jep autorin nëpër shenjat e tekstit, si kuptim i jetës njerëzore dhe përvojës personale në jetë. Ajo ka në themel refleksionin mbi ekzistencën, e përthyer në trajtat e njohjes e të vetënjohjes, si një metafizikë e thellë e këtyre dy koncepteve. Kërkesa për të vërtetën njerëzore, e bën antropoetikisht të pasur kozmologjinë autoriale dhe shtrihet gjithandej saj.

Poezia e Rreshpjes në esencë lidhet me subjektin, kështu, ai del të jetë poeti i formulave poetike intime. Rrëfimi poetik i mbushur me shenja personale është i ndjeshëm e esencial kur i këndon shpirtit njerëzor. Formulatat poetike intime, detajet e imazhet që lidhin tekstet fillimisht e në thelb me emocionet, me jetën dhe ideologemën personale, bëjnë që autori e ligjërimi në poezi t'i ngjajnë njëri-tjetrit. Këtë rend strukturimi ndjek dhe poezia e tij: nga jeta në fikcion, nga emocioni në figurë.

Teksti / Komunikimi

Filozofia e motivimit gjuhësor të Rreshpjes e do tekstin me gjuhë të figurshme, me mallin për tekstin si burim të shenjueshmërive. *Zotërimi i*

² F. Rreshpja, Intervistë.

³ K. Rrahmani, vepër e cituar, f. 208.

*metaforës si esencë poezie, e bën thellësisht të ndjeshme figurën e poezisë së Rreshpjes duke e bërë atë esencë të stilit dhe gjuhës së tij. Vetë magma e poezisë së tij, duke përfshirë edhe metaforën si emërtim të kësaj gjendjeje, e bën vetë stilin e kësaj poezie.*⁴

Një tendencë e tillë në strukturën e poezive bën bashkë figurën, emocionin dhe idenë e tekstit. Autori që diskursin lirik ka në esencë vesh emocionin me figurë dhe figurën e koncentron si ide.⁵ Figurimi letrar qoftë kur i ikë figurimit tradicional kulturor e politik, e qoftë kur shfrytëzon *metaforat konvencionale*⁶ duke u dhënë elemente të veta konceptuale; apo shenjave simboliste në poezi që transcendojnë diskursin e zakonshëm për të shenjuar dhembjen personale; të shenjave për simbolikën e zemrës që dhemb e njeriun e vetmuar, bën diskursin poetik t'i ikë figurimit arbitrar e të përcaktojë individualen dhe identitetin e tij.

Dy metafora që zënë sa herë vendin melikës së dashurisë së Rreshpjes, tregojnë të kundërtën e metaforës së jetës, rinisë, vrullit, gëzimit: *Vjeshta* dhe *Dimri*. *Vjeshta* është metaforë e emocioneve të trishta dhe e jetës që kalon, *Dimri* metaforë e ngricës në shpirt dhe e plakjes si ligj biologjik njerëzor. Ato flasin për ankthin, mërzinë, mungesën, vetminë, udhën e tij drejt një pleqërie të vetmuar dhe vdekjes që nuk vjen. Semantika e tyre jep gjendjen psikike e filozofike të personit poetik. Varri, kryqi, kufoma, dheu, vaji i erës, hëna e shuar, muzgu, druri i vdekur, si figura të trishtimit, të dhembjes e të vetmisë së subjektit. Realiteti poetik është i mbushur me zinë e heroit, gjuhën mashkull të të cilit e shkelë gjuha e emocioneve, duke nxjerr tonin e mbytur dhe botën e poezisë banuar nga figura të zeza. Një botë e pafuqishme e qenies njerëzore, që në pamundësi për ta ndryshuar atë thur figurat e zeza të vetmisë e të elegjisë mbi vdekjen. Nëse lumturia ishte dikur edhe pjesë e tij, sot është veç helmi që e përcjellë në jetë.

Fryma e krishterë që rri si intertekst kulturor në këtë poezi të intimes së thellë, e në veçanti në poezitë e dëshirës erotike të saj, na mëson se shpirti është ai që e sfidon trupin, dhe ai që ndjek kohën universale, para së cilës koha trupore është e pahetueshme.

Dashuria e heroit lirik është kryqi e udhëkryqi i tij, fizik e metafizik. Rënia shpirtërore, rënia fizike dhe në tërësi, rënia e motivimit jetësor, motivohet e mbahet vetëm në poezinë. Kësisoj, poezia vjen si çlirim, shpëtim nga malli e emri.

Sipas botëkuptimeve kulturore e fetare vdekja është në idetë e jashtme, derisa vdekja në fjalët poetike pretendon modernitetin artistik. Kështu, poezia rreshpiane bëhet ligjëratë e njeriut të prekur shpirtërisht, e dhënë në vargje të rregullta, plot muzikalitet. Vargjet rrallë ndjekin rimën, për të përcjellë muzikën, stilin e zgjedhur dhe stërhollimet stilistike, duke e bërë autorin të kujdesshëm edhe në formën e saj e në motivimin estetik.

⁴ K. Rrahmani, *Letra e Ideologji, një hyrje shkurte në letrat shqipe*, 99 Aikd, Prishtinë, f. 206.

⁵ Z. Kovács, *Metaphor, A Practical Introduction*, kapitulli 4, *Metaphor in Literature*, Oxford University Press, 2010, f. 49-60.

⁶ Po aty, f. 53.

Si poezi e diskursit intim që i referohet plotësisht emocioneve e figurimeve autoriale⁷, ajo përputhet me kodin tematik të saj. Kthimi tërësisht nga vetja dhe dëshmia e esencës personale si markë e komunikimit poetik, jep poezinë që vendin e vet si temë e motiv e vë dhe e mat me masën e brendisë. *Poezia është gjuhë e gjendje krize*, thoshte Mallarmé.⁸ Duket se Rreshpja ka arritur ta sublimojë “krizën” e vet në mitin personal të diskursit letrar, për ta shndërruar këtë diskurs në një mit të modernitetit të letrave shqipe.

BIBLIOGRAFI

F. Rreshpja, *Enise, Enise*, Rilindja, Prishtinë, 1975.

F. Rreshpja, *Në vetmi*, Arbëria, Tiranë, 2004.

K. Rrahmani, *Letra e Ideologji, një hyrje shkurte në letrat bashkëkohore shqipe*, Aikd 99, 2012.

M. Heidegger, *Poetry, Language, Thought*, Albert Hofstadter, H. & Row, 1971.

Modern Criticism and Theory, A Reader, edited by David Lodge, Longman, London and New York, 1988.

Teori dhe kritikë moderne, Rozafa, Prishtinë, 2008.

Z. Kovecses, *Metaphor, A Practical Introduction*, Oxford, University Press, 2010.

⁷ Shih: M. Heidegger, *Poetry, Language, Thought*, Albert Hofstadter, H. & Row, 1971.

⁸ Përkthyer e botuar nga Frederik Chase në *Stephane Mallarmé*, 1969, f. 23.